



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 159 Prot.

Tiranë, më datë 01.03.2021

**VENDIM**  
**Nr. 109 datë 01.03.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, Pika V, 1 për rinovimin e licencave në fushën e Trashëgimisë Kulturore, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.03.2021:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Albstar-Shpk” rinovimin e licencës R.Sh. 7 (zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi), për nënkategoritë e reja N-Z/A/1, N-Z/A/2, N-Z/A/3, N-Z/A/4, N-Z/A/5, N-Z/A/6, N-Z/A/7, me drejtues teknik Z.Mario Tashi;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
Arta DOLLANI

**KRYETAR**  
Elva MARGARITI

